

Fituesit e Çmimit të Guvernatorit ndër vite

Gjatë vitit 2008, u dhanë çmimet e mëposhtme:

- Çmimi i parë: z. Vasil Zaho, student në Universitetin “Middlesex Business School”, për temën “Efikasiteti dhe rritja e produktivitetit të bankave shqiptare nga 1996-2006”.
- Çmimi i dytë: z. Arens Arbana, student në Universitetin La Sapienza, Romë, për temën e masterit “Indeksi i Çmimit të Konsumatorit: Analizë e serisë historike në Shqipëri”.
- Çmimi i tretë: z. Leon Petani, student në Universitetin Dokuz Eylul në Turqi, me temën e masterit “Hyrja e bankave të huaja në sistemin bankar të vendeve në tranzicion: Rasti i Shqipërisë”.



Gjatë vitit 2007, u dhanë çmimet e mëposhtme:

- Çmimi i parë, z. Drini Imami dhe z. Endrit Lami, studentë në Masterin Shkenca Ekonomike Evropiane, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Bambergut, për temën: "Kërkimi për një cikël politik të biznesit në Shqipëri".
- Çmimi i dytë, zj. Ersida Doçaj, studente në London Metropolitan University, për temën: "Cili ka qenë impakti i sistemit bankar në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë në vitet 1992-2006?" .
- Çmimi i tretë, z. Afrim Laçi, student në Universitetin e Shkodrës për temën: "Turizmi dhe potencialet e tij në diversifikimin e ekonomisë në zonën e Pukës".



Gjatë vitit 2006, u dhanë çmimet e mëposhtme:

- Çmimi i parë, zj. Gizelda Emini, studente e Universitetit të Tiranës, për temën: “Fondet private të pensioneve, analiza dhe opinione”.
- Çmimi i dytë, z. Arbër Boriçi, student i Universitetit të Nju Jorkut në Tiranë, për temën: “ Procesi i kursit të këmbimit Lekë/ Dollarë: A ishin ndryshimet e njëpasnjëshme të tij një “lojë e pastër”? Tregues nga Shqipëria: janar 1998- tetor 2005.
- Çmimi i tretë, zj. Lorena Gega studente e Universitetit të Tiranës, për temën: “Shqipëria dhe integrimi në Bashkimin Evropian”.

